

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 847 Prot.

Tiranë, më 19.062017

VENDIM Nr. 126, datë 05.06.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*", në sitin ABV 28, Stacioni i Bllokut të Valvulave të Sigurisë, në rrethin e Skraparit, Therepelë. "- Subjekti "SPIECAPAG Shqipëria". paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*Linja e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)*", në sitin ABV 28, Stacioni i Bllokut të Valvulave të Sigurisë, në rrethin e Skraparit, Therepelë- subjekti "- Subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazsjellësit TAP, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të KKA Nr. 74, datë 28.06.2016, për Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor për Stacionet e Valvulave Bllokuëse, Sheshet e Magazinimit të Tubave dhe Kampet e Punëtorëve (20 objekte), në kuadër të projektit "TAP"-subjekti "TAP-AG".
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al